



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO



Datë: 22.08.2025
Numër Protokolli: 5671/2025

A.nr.1267/2025

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendorsjen e Ankesave i përbërë nga: Ardita Haxhnikaj Demi, kryetare, Malsore Gashi-Bajraktari dhe Eshref Shabani, anëtarë, me Avdyl Bekteshi, në cilësinë e procesmbajtësit, në procedurë sipas ankesës me numër A.nr.1267/2025, të datës 02.07.2025, të parashtruar nga ankuesja G.T, kundër organit të punësimit: Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, në çështjen juridike “*Kontestim konkursi*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6, paragrafi 1, nën paragrafi 1.1, dhe nenin 18, paragrafi 1, nën paragrafi 1.5 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 22.08.2025, mori këtë:

V E N D I M

Përfundon procedimi administrativ i filluar sipas ankesës me numër A.nr.1267/2025, e datës 02.07.2025, e parashtruar nga ankuesja G.T.

A r s y e t i m

Kandidatja për pranim në shërbimin civil, G.T (në *tekstin e mëtejme referuar*: Ankuesja), me datë 02.07.2025, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër procedurës së pranimi sipas konkursit Nr. Reference RN00017357 për grupin e shkencave shoqërore, për pozitën Inspektor i Tregut, i shpallur nga Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (në *tekstin e mëtejme referuar*: Këshilli) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendorsjes së Ankesave, me datën 14.07.2025 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë (tutje MINT), ndërsa kjo e fundit me datë 17.07.2025, ka dorëzuar përgjigjen në ankesë se bashku me shkresat e lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendorsjen e Ankesave, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës të parashtruar nga palët në procedurë, ka konstatuar se janë përmbushur kushtet për përfundim të procedimit administrativ të filluar sipas ankesës A.nr.1267/2025, sepse:

Nga administrimi i shkresave të lëndës, rrjedhë së MINT më datë 24.03.2025, ka shpallur konkursin me Nr. Reference: RN00017357, Grupi i Shkencave Shoqërore, për pozitën e punës “*Inspektor i Tregut*”, numri i kërkuar shtatë (7) pozita, klasa e pozitës profesional 1, me afat aplikimi nga data 25.03.2025 deri më datë 23.04.2025.

Tutje, nga shkresat e lëndës rezulton se në këtë konkurs kanë aplikuar 221 kandidatë, ndërsa fazën e verifikimit paraprak e kanë kaluar 165 kandidatë, në mesin e tyre edhe ankuesja, e cila i është nënshtruar testit me shkrim duke marr 22.6 pikë.

Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore e MINT, më datë 03.06.2025, ka publikuar Njoftimin me numër protokolli 2126/03 për kandidatët fitues , ashtu që si kandidat fitues janë Z.T me gjithsej 86.2 pikë, K.Xh me gjithsej 85.2 pikë, I.G me gjithsej 78.4 pikë dhe I.B me gjithsej 77 pikë.

Ankuesja në ankesën e parashtruar përmes postës në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil, pretendon se gjatë procedurës në fjalë ka pasur shkelje procedurale dhe substanciale tek vlerësimi i testit me shkrim dhe mospërputhje e testit me shkrim me pozitën e shpallur, është cenuar parimi i barazisë në konkurrim, nuk ka pasur transparencë. Kërkon që të aprovohet ankesa të anulohet konkursi.

Bazuar në të dhënat e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, rezulton se kandidati J.K, si kandidat aplikues në procedurën e rekrutimit me Nr. Reference: RN00017357 për Grupi i Shkencave Shoqërore, për pozitën e punës “*Inspektor i Tregut*”, kishte parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër procedurës së njëjtë, ndërsa, Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me Vendimin me numër A.nr.1211/2025, të datës 21.08.2025, ka anuluar në tersi procedurën e pranimi sipas konkursit Nr. Nr. Reference: RN00017357.

Andaj, referuar gjendjes se fakteve si më lartë dhe duke marrë parasysh se objekti i kontestit sipas ankesës A.nr.1267/2025, të datës 02.07.2025, ka të bëjë me procedurën e pranimi për të cilën Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës ka vendosur në mënyrë meritore me Vendimin A.nr.1211/2025, të datës 21.08.2025, rrjedhimisht ka anuluar procedurën e pranimi sipas konkursit Nr. Reference: RN00017357, atëherë mbi bazën e këtyre rrethanave, e në kuptim të dispozitave të nenit 104 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative më të cilat është përcaktuar se: “*Procedura administrative gjithashtu përfundon kur organi publik kompetent vlerëson se objekti për të cilin ishte nisur procedura ose qëllimi i saj është bërë i pamundur apo i kot*”, Kolegji vlerëson se objekti i ankesës A.nr.1267/2025, është bërë i pamundur për shqyrtim dhe vendosje.

Kështu që, në mbështetje të nenit 18, paragrafi 1, nën paragrafi 1.5 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës si dhe nenin 104 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kolegji vendosi që të përfundoj procedimin administrativ të filluar me ankesën A.nr.1267/2025, të datës 02.07.2025.

Këshillë juridike: Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.1267/2025

Avdyl BEKTESHI

Procesmbajtës

Ardita Haxhnikaj DEMI

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dorëzohet:

- Ankueses G.T;
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në MINT; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.